



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E MBROJTJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT

Nr. 132/1 Prot.,

Tiranë, më 22.1.2024

URDHËR
Nr. 30, datë 22.1.2024

"PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT 2024-2025"

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 7 të ligjit Nr.9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit" i ndryshuar, Vendimit Nr. 516, datë 01.07.2020 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.247, datë 20.03.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020" dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023 në zbatim të strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 dhe pasaportës së indikatorëve", dhe në vijim të Draft Planit të Integritetit 2024-2025 të DPRMSH të hartuar nga grupi i punës caktuar me Urdhrin Nr.89, datë 09.05.2023 "Për hartimin e planit të integritetit" të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Integritetit 2024-2025 të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ky urdhër publikohet për njohje në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit www.dprms.gov.al.
3. Ngarkohen të gjitha Drejtoritë operative në DPRMSH dhe Drejtoritë Rajonale të varësisë, Tiranë, Shkodër, Dibër, Fier dhe Korçë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Robert HYSENLLARI





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E MBROJTJES

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT

PLAN INTEGRITETI
2024-2025

Miratuar me Urdhrin e Brendshëm Nr.30, datë 22.01.2024 të Drejtorisë të Përgjithshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit "Për miratimin e planit të integritetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit 2024-2025".

Ky plan integriteti është hartuar në përmbushje të Vendimit Nr. 516, datë 01.07.2020 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.247, datë 20.03.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020", dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 dhe pasaportës së indikatorëve".

Qëllimi kryesor i këtij Planit Integriteti është parashikimi i objektivave që në thelb kanë mirëfunksionimin institucional të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, në vijim të përpjekjes së vazhdueshme të Administratës Publike Shqiptare në kuadër të luftës kundër korrupsionit, dhe forcimit të vlerave themelore si integriteti, etika dhe transparenca.

Grupi i punës ngarkuar me hartimin e Planit të Integritetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit:

- Kryetar: Vili VREONI, Drejtor i Drejtorisë Teknike, Standardeve dhe Cilësisë
- Anëtarë: Brixhilda MUZHO, Përgj. Sek. Juridik, i komanduar Drejtor i DMBNJ&SH
Eriola HASHO, Specialist Inxhinier Ndërtimi në DTSC
Eriselda ZEQAJ, Specialiste kontabiliteti në DPF
Ornela KOÇI, Specialiste buxheti në DPF

TABELA E PËRMBAJTJES

<i>LISTA E SHKURTESAVE</i>	4
<i>DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL</i>	5
<i>HYRJE</i>	6
<i>QËLLIMI I DOKUMENTIT</i>	6
<i>I. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT</i>	6
1.1. <i>Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit</i>	6
1.2. <i>Identifikimi dhe analiza e riskut</i>	7
1.3. <i>Vlerësimi i risqeve të integritetit</i>	7
1.4. <i>Plani i veprimt për menaxhimin e riskut</i>	7
<i>II. QASJA METODOLOGJIKE</i>	7
<i>III. OBJEKTIVAT STRATEGJIK TË VENDOSUR PËR VITET 2024-2025</i>	8
<i>IV. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT</i>	8
1. <i>Fusha administrative</i>	8
2. <i>Fusha operationale</i>	9
3. <i>Fusha e menaxhimit financiar</i>	10
<i>V. PLANI I VEPRIMIT 2024-2025</i>	11
Forcimi i Transparencës.....	11
Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të Burimeve Njerzore.....	13

LISTA E SHKURTESAVE

DPRMSH – Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit

DMBNJ – Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve

DTSC – Drejtoria Teknike Standardeve dhe Cilësisë

DPF – Drejtoria e Planifikimit dhe Financës

DRRMSH – Drejtoria Rajonale e Rezervave Materiale të Shtetit (Tiranë, Shkodër, Dibër, Fier dhe Korçë)

PI – Plani i Integritetit

MVRI – Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Përballja me impaktin negativ të korrupsionit dhe me perceptimin e tij është një sfidë e vazhdueshme e të gjithë institucioneve të Administratës Publike në Shqipëri, dhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit është tepër e rëndësishme arritja e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, me qëllimin e vetëm për t'ju shërbyer qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dhe për të rritur besimin e tyre tek institucionet shtetërore.

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit si institucioni që ka për qëllim dhe objektiv kryesor ndërhyrjen, në mënyrë operative, për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe mbrojtjen e vendit, në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, veprimeve terroriste, veprimeve ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin, si dhe duke vlerësuar që ky është një rol kryesor në përballimin e emergjencave civile jemi të vetëdijshëm se duhet të jemi ndër të parët që të japim shëmbullin për t'i shërbyer interes publik, në mënyrë që të gjitha veprimet tona të jenë me integritet të lartë.

Ky Plan është hartuar që të përfshijë të gjitha risqet e integritetit sipas fushave funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, dhe mendojmë se do të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së punës së institucionit tonë duke qënë se qëllimi kryesor i tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit.

Së fundmi synimi kryesor i këtij Plani Integriteti është krijimi i një mjedisi pune që së pari garanton integritet institucional dhe së dyti rritjen e besimit të publikut në rëndësinë e misionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit.

Drejtor i Përgjithshëm

Robert Hysenllari



HYRJE

Integriteti është themel i çdo sistemi të mirëqeverisjes, ashtu sikurse dhe një nga parimet themelore të sjelljes në institucionet shtetërore, krahas besueshmërisë, ndershmërisë, transparencës, objektivitetit dhe bashkëpunimit.

Koncepti i integritetit është vlerësuar më gjerësisht dhe përfshin në vetvete jo vetëm ndershmërinë dhe mungesën e korrupsionit, por dhe një sërë aspektesh që përbëjnë menaxhimin publik, të tilla si etika, sjellja dhe komunikimi profesional, standardet, vlerat, konfidencialiteti, transparenca, paanshmëria dhe llogaridhënia, garantimi i të cilave krijon një barrierë mbrojtëse ndaj korrupsionit.

Plani i Integritetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit është hartuar gjatë periudhës Mars-Nëntor 2023 duke u bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI).

Vlerësimi i risqeve dhe faktorëve të tyre është kryer për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë së institucionit. Këto fusha përfshijnë: a) Risqet administrative; b) Risqe operacionale; dhe c) Risqet që përfshijnë menaxhimin financiar.

QËLLIMI I DOKUMENTIT

Plani i integritetit i Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit do të shërbejë si një mjet gjithëpërfshirës që synon promovimin dhe forcimin e integritetit duke përfshirë këtu integritetin individual, profesionalizmin, etikën, si dhe zbatimin e vlerave morale dhe standardeve profesionale.

Ky qëllim do të realizohet nëpërmjet identifikimit të risqeve ndaj integritetit në strukturat dhe institucionet e varësisë dhe të vlerësojë nivelin e cënueshmërisë së tyre dhe nga ana tjetër të planifikojë masat e duhura për prandalimin dhe minimizimin e tyre.

Pikat kryesore ku do të fokusohet ky dokument:

- Menaxhimi i rrezikut të integritetit në DPRMSH dhe DRRMSH-të e varësisë;
- Vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat kompromentojnë aftësinë e DPRMSH-së për të kryer funksionin e shërbimit publik në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme dhe i faktorëve që mund të mbështesin apo rrisin risqet e vlerësuara;
- Formulimi i masave të nevojshme për shmangien e risqeve.

I. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtëme:

1.1. Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit me Urdhrin e Brendshëm Nr.89, datë 09.05.2023 "Për hartimin e planit të integritetit", të ndryshuar, ka ngritur grupin e punës për vlerësimin e riskut të integritetit dhe hartimin e e Planit të Integritetit. Në përbërje të grupit të punës kanë qënë specialistë dhe ndrejtuës të DPRMSH-së, të cilët kanë realizuar procesin e identifikimit dhe vlerësimit të risqeve të integritetit, si dhe hartimin e Planit të Integritetit.

1.2. Identifikimi dhe analiza e riskut

Gjatë kësaj faze grupi i punës u siguroi të analizonte kuadrin ligjor në fuqi, si dhe kuadrin e brendshëm rregullator i cili ka një rol thelbësor për veprimtarinë e institucionit. Më pas nga ana e grupit të punës u vijua me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës në fushat funksionale të DPRMSH-së.

Pjesë e kësaj analize është dhe feedback i marrë nga stafi i institucionit mbi perceptimin e tyre për integritetin dhe etikën në institucion për tëbërë një vlersim sa më të mirë të njohurive të tyre lidhur me kuadrin rregullator të që si fokus kyesor ka integritetin në ushtrimin e funksioneve publike.

1.3. Vlerësimi i risqeve të integritetit

Në këtë fazë grupi i punës vlerësoi risqet e analizuara në fazën e mëprashme duke u mbështetur në mundësinë e risqeve për të ndodhur dhe në ndikimin në rast të ndodhjes së riskut. Në vijim risqet e vlerësuara dhe faktorët e tyre u renditën sipas përparësisë.

Procesi vijoi me vlerësimin e efektivitetit të masave ekzistuese të kontrollit në institucion për risqet e vlerësuara dhe me propozimin e masave të reja për trajtimin e tyre.

1.4. Plan i veprimit për menaxhimin e riskut

Grupi i punës hartoi planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, i cili përfshin masa të reja kontrolli apo përmirësim të masave ekzistuese.

Këto masa parashikojnë kryesisht aktivitete që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre.

II. QASJA METODOLOGJIKE

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit e cila u bë në përputhje me MVRI, u përdorën dy metoda:

- Metoda cilësore
 - Përmes zhvillimit të diskutimeve me stafin e institucionit, ku morën pjesë pjesa më e madhe punonjësve rreth (në total 30 punonjës) të cilëve ju kërkua mendim mbi perceptimin për tema të caktuara që përfshijnë integritetin.
 - Përmes analizës së kuadrit rregullator të brendshëm të institucionit (Rregullore të brendshme, procedura pune etj).
- Metoda sasiore
 - Përmes vlerësimit më anë të një pyetësori, në të cilin punonjësit e DPRMSH dhe DRRMSH-ve të varësisë u përgjigjën pyetjeve mbi çështje të veçanta të integritetit dhe etikës në institucion. Ky pyetësor u plotësua në mënyrë anonime nga pjesa më e madhe e punonjësve.

III. OBJEKTIVAT STRATEGJIK TË VENDOSUR PËR VITET 2024-2025

Nëpërmjet miratimit të këtij Plani Integriteti, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit ka vendosur tre objektiva të realizueshëm brenda periudhës 2024-2025, nëpërmjet të cilave synohet që të minimozohen dhe adresohen risqet e konstatuara. Objektivi përfundimtar i këtij plani është ndërtimi i një sistemi të brendshëm efektiv dhe forcimi i kulturës së integritetit instucional.

Disa nga parimet e përgjithshme mbi bazën e të cilës është bërë hartimi i këtij dokumenti dhe përcaktimi i objektivave më poshtë janë: *Parimi i ligjshmërisë, Parimi i unitetit dhe hierarkisë, parimi i llogaridhënies, parimi i transparencës, Parimi i paanshëmrisë, Parimi i idcentralitetit etj.*

Tre objektivat e vendosur nga DPRMSH për periudhën 2024-2025 janë:

- Sigurimi i një niveli të lartë të transparencës për publikun;
- Forcimi i mekanizmave të brendshëm rregullator dhe kontrollit;
- Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore.

IV. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT

Në këtë seksion do të trajtojmë në mënyrë të përmbledhur analizat dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit në DPRMSH.

Më poshtë janë rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut në fushat e përgjegjësisë së institucionit:

1. Fusha administrative

Nga vlerësimi i risqeve na rezulton se publiku ka shumë pak informacion lidhur me funksionin dhe misionin e DPRMSH ku ndër disa nga faktorët që kanë ndikuar janë:

Së pari informacioni i pakët që publiku ka mbi funksionimin e Rezervave të Shtetit dhe misionin e saj dhe së dyti mungesa e qasjes proaktive nga ana e institucionit për të promovuar punën e tij dhe rëndësinë e institucionit përsa i përket rolit të tij në përballimin e emergjencave civile.

Një pikë tjetër shumë e rëndësishme që ka ndikim direkt në mirë funksionimin instucional dhe procesin e integritetit është dhe përputhshmëria ligjore/ procedurale me ndikim në kuadrin rregullativ ligjor, i cili ka impakt në marrëdhëniet me institucionet e tjera dhe palë të treta.

Kjo është fushë e cila ka një ndikim të drejtpërdrejtë ndaj integritetit instucional pasi hapësirat ligjore lënë vend për keqinterpretime legjislative.

Disa nga risqet e vleresuara për këtë pikë janë:

- Nevoja për ndryshime thelbësore ligjore (të cilat përfshijnë miratimin e ndryshimeve ligjore për Ligjin Nr. 9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij ose miratimin e një kuadri të ri ligjor).
- Përcaktimi i përditsuar i sasive minimale dhe maksimale sipas nevojave për mallra ushqimore dhe industriale pjesë të nomenkaturës së mallrave rezervë shteti.
- Përplasje e kompetencave direkte dhe indirekte me Ligjin Nr. 34, datë 04.07.2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara".

- Nevoja për përcaktimin e një kuadri ligjor lidhur me ruajtjen e mallrave rezervë shteti pranë subjekteve ekonomike private.

Së fundmi një nga risqet e vlersuara të rendësishme që ndikojnë në mirëfunksionimin administrativ është dhe menaxhimi i Burimeve Njerëzore (Procedura e rekrutimit, plotësimi i strukturës organike), ku ndër faktorët kryesorë shkaktarë janë:

- Mungesa të theksuara të personelit në strukturën organike të DPRMSH dhe DRRMSH-ve të varësisë.
- Ndjekja e procedurave të tej-zgjatura për rekrutim nga Njësia Përgjegjëse DAP.
- Mungesa e interesit të aplikantëve për pozicione pune kryesisht në DRRMSH-të rajonale (Shkodër, Dibër dhe Vlorë).

2. Fusha operationale

Nga praktika shumë vjeçare e institucionit, si dhe përballimi i emergjencave civile të një pas njëshme, siç ishin tërmeti i Nëntorit të vitit 2019 dhe pandemia e COVID, kanë evidencuar disa problematika të cilat kanë të bëjnë jo vetëm me pjesën logjistike të menaxhimit të mallrave edhe me pjesën e administrimit të tyre dhe magazinimit në vende që i përmbushin standartet për ruajtje të mallrave specifik.

Më konkretisht një nga risqet e para të evidencuara sa i përket pjesës operationale është menaxhimi i aseteve të DPRMSH (Pronat në administrim) dhe disa nga faktorët që kanë ndikuar më së shumti në këtë aspekt janë:

- Mungesa e një përcaktimi të saktë të zhvendosjes së aktivitetit të Agjencisë Lundër (të gjitha aseteve pjesë përbërëse të saj si dhe të mallrave të magazinuar në këtë agjenci) pas kalimit në administrim të Fondit shqiptar të Zhvillimit.
- Problematikat e mbivendosjeve të evidencuara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për një pjesë të pronave në administrim të DPRMSH.
- Problematika e zaptimit të paligjshëm të disa prej pronave në administrim të DPRMSH (proceset gjyqësore për fitimin e tyre me parashkrim fitues nga ana e zaptuesve).
- Gjendja infrastrukturore e pronave, ku rreth 80% e tyre janë në kushte të amortizuara dhe kanë nevojë për rikonstrukcion.
- Mungesa e rojeve në organikë për të siguruar ruajtjen e gjithë agjencive në përgjegjësi administrimi.

Një risk i tillë përbën efekt domino dhe për riskun tjetër operacional i cili lidhet ngushtësisht me misionin kryesor të DPRMSH që është administrimi i mallrave Rezervë Shteti, ku ndër faktorët e evidencuar që kanë më shumë ndikim tek ky risk janë:

- Mungesa e ambienteve magazinuese me kushte të përshtatshme për magazinimin e mallrave ushqimore që kërkojnë kushte të veçanta ruajtje.
- Vakanca ligjore për rregullimin e një procesi më gjithpërfshirës lidhur me rifreskimin e mallrave ushqimore.
- Mungesa e kuadrit ligjor rregullator për sigurimin e pjesëmarrjes së rezervave materiale të shtetit pjesë të institucioneve të mbrojtjes civile në nivelin ndërkombëtar, si për sigurimin e ndihmave humanitare ashtu dhe lërvrimin e mallrave rezervë shtetërore në ndihmë të vendeve të tjera.

3. Fusha e menaxhimit financiar

Pjesë e procedurave financiare të institucionit janë procedurat e Ankandëve Publike dhe procedurat e Prokurimeve publike, por duhet të theksojmë që risqet sa i përket kësaj fushe dhe këtyre procedurave konkrete i jashtë shkruhen kompetencave të DPRMSH pasi si faktor kyresor për shkaqet e reskut janë:

- Pjesëmarrje dhe interes i vogël i subjekteve ekonomike për blerjen e mallrave në ankand publik kjo për shkak të çmimeve të larta të aplikuara sipas dispozitave ligjore për shitjen në ankand të mallrave.
- Pjesëmarrja në ankand e operatorëve ekonomikë të cilët nuk kanë pjesë të aktivitetit të tyre procedurën për të cilën shfaqin interes pjesëmarrje, duke përfshirë pakënaqësi dhe ankesa si rezultat i skualifikimit të tyre për mosplotësim të kriterëve të veçanta të vendosura nga autoriteti shitës.
- Akordimi i fondeve të ulëta e në disproporcion me nevojat e parashikuara nga DPRMSH.
- Mosakordimi i fondeve për të gjitha nevojat e DPRMSH të parashikuara në PBA duke nënvleftësuar rëndësinë e institucionit dhe cënuar disponueshmërinë e tij në rast nevoje.
- Mosvecimi si kod buxheto më vete i rezervës materiale të shtetit duke sjellë si pasojë akordimin e fondeve në masë vetëm emergjencave civile (nën të njëjtin kod buxhetor).

Referuar risqeve të renditura më sipër nga ana e DPRMSH është treguar kujdes në zhvillimin e procedurave duke u mbështetur në parimin e transparencës, efektivitetit, decentralizimit dhe llogaridhënies.

Të gjitha këto problematika (risqe) janë raportuar shpesh në institucionet eprorë, gjithashtu vlen të theksohet se DPRMSH i është nështruar kontrolleve periodike nga autoritete me të larta më funksione kontrolli si Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjithashtu i nënshtrohet kontrolleve të vazhdueshme periodike me Sektorin e Auditit të Brendshëm në DPRMSH. Aktualisht DPRMSH ka ndërmarrë iniciativën ligjore për ndryshimin e legjislacionit të saj dhe për vitin 2024 pjesë e objektivave të saj mbeten dhe iniciativat e reja me qëllim shmangien eliminimit të risqeve të sipërcituara.

V. PLANI I VEPRIMIT 2024-2026

Plani i Veprimit përfshinë tërësinë e masave për të zvogëluar impaktin e risqeve dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë së DPRMSH.

Ky plan është një dokument plotësues i politikave dhe kornizës rregullore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Hartimi i këtij plani ka për qëllimin arritjen e objektivave për forcimin e integritetit si më poshtë:

- Sigurimi i një niveli të lartë të informimit dhe transparencës për publikun;
- Forcimi i kuadrit dhe mekanizmeve të brendshëm rregullator dhe kontrollit;
- Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore.

Forcimi i Transparencës

Nr. Aktivitet	Vitet	Shtetas dhe Përfundim	Principi	Risiku dhe Faktorët e Risikut	Masa për adresimin e risikut	Burimet
1. Përditësimi i informacionit në faqen web të DPRMSH, publikimi i informacioneve të rëndësishme lidhur me aktivitetin	Periodikisht çdo 3 muaj	DMBNJ&SH, në DPRMSH	I lartë	Mungesa e Transparencës ndaj publikut	Përgatitja e të gjithë informacionit që konsiderohet i nevojshëm për publikun	Stafi i DPRMSH pa kosto shtesë

Përmirësimi i kuadrit ligjor

Nr. Aktivitet	Vitet	Shtetas dhe Përfundim	Principi	Risiku dhe Faktorët e Risikut	Masa për adresimin e risikut	Burimet
1. Ndryshimi i legjislacionit aktual për rezervat materiale të shtetit, ligjin Nr. 9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat e shtetit", i ndryshuar,	2024-2025	DPRMSH dhe Ministria e Mbrojtjes	I lartë	Mungesa e koherencës së legjislacionit aktual mbi të cilin ka vepruar rezerva e shtetit me legjislacionin në fuqi për	Përgatitja e një draft propozimi për ndryshimet e nevojshme dhe dërgimi për miratim pranë Ministrisë së Mbrojtjes	DPRMSH dhe personeli i ngarkuar me Urdhën të Ministrit të Mbrojtjes pjesë e grupit të punës për cdo akt.

	VKM Nr. 1128/2008 "Për krijimin dhe administrimin e rezervave materiale të shtetit"				mbrojtjes civile si dhe aktet e reja ligjore e nënligjore të Republikës së Shqipërisë.		
2.	Propozimi për përmirsimin e kuadrit legjislativ lidhur me ruajtjen e e mallrave rezevë shteti pranë subjekteve ekonomike private.	2024- 2025	DPRMSH	I lartë	Mungesa e ambienteve të përshtatshme për magazinimin e mallrave, e cila ndikon drejtpërdrejt në procedurat e blerjes, shitjes së mallrave.	Përgatitja e një draft propozimi për mirëpërcaktimin e procedurës së përzgjedhjes së operatorëve ekonomik, kostos së mundësimit të këtij procesi si dhe sanksioneve ndaj subjekteve në rast mosplotësimi të kushteve kontraktuale për këtë qëllim.	DPRMSH në bashkëpunimin me subjektet private të cilat do të ndihmojnë në gjetjen e mekanizmave sa më efektive për sigurimin e këtij procesi me fektivitet.
3.	Rishikimi i rregulloreve të brendshme të DPRMSH, duke siguruar, përfshirjen e funksioneve /njësive të tjera që janë të lidhura ngushtësisht me të drejtën për informimin, si dhe hartimi dhe publikimi i kuadrit rregullator që lidhet me	2024- 2025	DPRMSH dhe Ministria e Mbrojtjes	I lartë	Mos- përmbyshja e parimeve kryesore të integritetit gjatë ushtrimit të detyrave funktionale dhe në rastet e përfaqimit të institucionit në çdo formë	Përvetsimi i praktikave të mira lidhur me parimin e integritetit dhe hartimi, miratimi i rregullave dhe Procedurave që garantojnë integritetin	Stafi DPRMSH, pa kosto shtesë financiare

parimet e integritetit në institucion							
---------------------------------------	--	--	--	--	--	--	--

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të Burimeve Njerzore

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të Burimeve Njerzore							
1.	Plotësimi i pozicioneve vakante të punës	2024-2025	DMBNJ&SH në bashkëpunim me DAP	I lartë	Mbingarkesë në detyra e stafit aktual çka bën ulje të efektivitetit të punës	Deklarimi i pozicioneve vakante pranë DAP dhe ndjekja e procedurave të rekrutimit	Burimet Njerzore të institucionit pa kosto shtesë financiare
2.	Evidentimi i vazhdueshëm i nevojave për trajnim i stafit	2024-2025	DPRMSH në bashkëpunim me ASPA	I mesëm	Ulja e standardit të punës is pasojë e mungesës së kualifikimit të stafit	Ndjekja e trajnimeve të zhvillura nga ASPA	Stafi i DPRMSH pa kosto shtesë financiare